



**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**  
Nr. 02-060/01-0005630-5/26, dt. 10.02.2026  
**Mitrovicë**

02 Mitrovicë Jugorë 02-060/01-0005630-5/26  
Më 10.02.2026  
E përditësuar 10.02.2026  
Secili Mitrovicë - Mitrovica

Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika d, dhe 58 pika h, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); në nenin 13, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 dhe 77 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 të Statutit të Komunës; nenit 7 të Ligjit Nr. 04/-L-076 Për policinë; dhe në bazë të nenit 3, të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB dhe 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 10.02.2026, sjell këtë:

**VENDIM**

**Për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi**

1. Me këtë vendim THEMLOHET Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB).
2. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve në komunë dhe përfaqësues të shoqërisë civile.
3. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka këtë përbërje:
  - 2.1 Faton Peci - Kryetar i Komunës dhe Kryesues i Këshillit,
  - 2.2 Komandanti i Stacionit të Policisë;
  - 2.3 Nga një përfaqësues legjitim i secilës bashkësi fetare të komunës.
  - 2.4 Nga një përfaqësues të secilit komunitet etnik të komunës;
  - 2.5 Kryesuesi i Komitetit për Komunitete të Kuvendit të Komunës;
  - 2.6 Besa Veseli - Zyrtare për Barazi Gjinore;
  - 2.7 Shefki Begu - Drejtor i Drejtorisë për Arsim;
  - 2.8 Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit në Komunë;
  - 2.9 Një përfaqësues i FSK-së;
  - 2.10 Një përfaqësues i secilit Këshill Lokal për Siguri Publike;
  - 2.11 Kryesuesi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi;
  - 2.12 Një përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunal;
  - 2.13 Enes Kaqapor - Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim;
  - 2.14 Oktaj Hasani përfaqësues nga OJQ-të
  - 2.15 Përfaqësues nga mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e KKSBB-së janë:
  - 3.1 Përgatitja e Planit vjetor të punës dhe zhvillimi i projekteve për rritjen dhe përmirësimin e sigurisë në bashkësi.
  - 3.2 Identifikimi i dukurive negative, që tentojnë të prishin sigurinë publike dhe rekomandojnë planet e veprimit.
  - 3.3 Bashkëpunimi me policinë për parandalimin e veprimeve, të cilat e kërcënojnë sigurinë në bashkësi.

- 3.4 Bashkëpunimi me institucionet qendrore, që merren me sigurinë publike me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt në bashkësi.
  - 3.5 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KKSB-të e komunave fqinje për çështjet e sigurisë në bashkësi, që i tejkalojnë kufijtë e Komunës së tyre.
  - 3.6 Të kërkojë nga Kuvendi i Komunës financimin e projekteve të lidhura me sigurinë e bashkësisë.
  - 3.7 Përmes Komunës të kërkojë nga ndonjë organizatë joqeveritare financimin e projekteve të lidhura me sigurinë e bashkësisë.
  - 3.8 Fton në takimet e tyre përfaqësuesit e MPB-së DSB.
  - 3.9 Fton përfaqësues nga institucionet qeveritare të mediave ose përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që të marrin pjesë në takimet e KKSB-së.
  - 3.10 Kërkon nga policia përgjegjëse për rastet, që janë me rëndësi për sigurinë e bashkësisë duke mos ndërhyrë në procesin e hetimit policor.
  - 3.11 Mbajtja e takimeve të rregullta ashtu siç përcaktohet në nenin 11 të këtij Udhëzimi Administrativ.
5. Kryesuesi i KSSB-së është Kryetari i Komunës dhe në mungesë të tij takimin e KSSB-së e kryeson Zëvendëskryetari me të drejta dhe përgjegjësi të plota ashtu siç i ka Kryesuesi i KKSB-së.
  6. Funkzioni i KKSB-së detyrat dhe përgjegjësitë e kryesuesit të KKSB-së përfaqësimi i Komuniteteve në KKSB, mbledhjet e KKSB-së, pjesëmarrja në mbledhje, vendimmarrja zëvendësimi i anëtarëve të KKSB-së, dorëheqja, bashkëpunimi, raportimi, mbikëqyrja etj., rregullohen me Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 MPB dhe 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.
  7. Sugjerimet dhe rekomandimet e KKSB-së mund të merren si rekomandime për veprime të institucioneve përkatëse.
  8. Anëtarët e KSSB-së kanë mandat të njëjtë me anëtarët e Kuvendit të Komunës.
  9. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
  10. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

**Mitrovicë**

**Dorëzohet:**

1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit

1 x 1 MAPL- së

1 x 1 Arkivit

**Kopje:** Kryetarit të Komunës  
Anëtarëve të Këshillit



**Kryesuesi i Kuvendit**

**Safet KAMBERI**